



**Analizë e draft rregullës për vet-konsumatorët me burime të
ripërtëritshme**

Përmbajtja

Hyrje	3
Komente specifike	4
Përfundime.....	7

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka bërë analizimin e draft rregullës për vet-konsumatorët me burime të ripërtëritshme. Kjo rregullore është vendosur në konsultim publik në faqen zyrtare të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në seksionin e konsultimeve publike.¹ Ky punim ka për qëllim të analizoj këtë rregullore, procedurat e marrjes së statusit "Prosumer", avantazhet dhe disavantazhet si dhe ndryshimet që duhen bërë në mënyrë që efekti i rregullores të jetë më pozitiv. Analiza është bërë si pjesë e programit të INDEP për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe është në vazhden e punës monitoruese të Institutit me qëllim të ofrimit të rekomandimeve për politika publike që promovojnë integrimin e burimeve të ripërtëritshme.

Prosumerët janë konsumatorë të energjisë elektrike të cilët shfrytëzojnë teknologjinë e burimeve të ripërtëritshme për prodhim dhe mbulim të kërkesës për energji elektrike. Integrimi i tyre në sektorin e enegjisë në Kosovë kontribuon në arritjen e caqeve të BRE, shtimin e prodhimit dhe përmirësimin e sistemit. Andaj rregullorja për këta konsumatorë është e mirëseardhur dhe e duhur, në kohën kur kriza energjetike vetëm se ka bërë dëme të mjaftueshme.

Rregullorja për vet-konsumatorët me burime të ripërtëritshme është një dokument i mirë për përcaktimin e parimeve dhe mekanizmat para dhe pas marrjes së statusit të Prosumerit. Për më tepër, rregullimi i kushteve për Prosumerët kontribuon edhe në arritjen e objektivave të draft Strategjisë së Energjisë 2022-2031. Andaj komentet e INDEP janë në linjë me të drejtat e konsumatorëve, përmirësimin e rrjetit dhe fuqizimin e sistemit elektroenergjetik të Kosovës.

¹ Zyra e Rregullatorit për Energji, Konsultime Publike, e qasshme në <https://www.ero-ks.org/zrre/sq/proceset-e-shqyrtimeve-te-rregullave-dhe-te-tjera>, (qasur në nëntor, 2022)

Komente specifike

Komenti 1. Të definohet “baza e energjisë së konsumuar”

Neni 5 – Kriteret për përfshirjen në Skemat Mbështetëse bënë ndarjen e konsumatorëve dhe nivelin e kapaciteteve gjeneruese që mund të instalohen. Ndarja e tillë është e kuptueshme dhe e mirëpritur, mirëpo INDEP kërkon që të definohet baza e energjisë së konsumuar. Të shpjegohet se si do të bëhet analiza e konsumit, a do të jetë analizë e konsumit të vitit të fundit, dy apo tre viteve të fundit. Një gjë e tillë është e nevojshme edhe për faktin e eliminimit të keqinterpretimeve në të ardhmen, të cilat mund të vijnë nga vetë konsumatorit apo edhe nga furnizuesi.

“Konsumatorët e energjisë elektrike të kyçur në tensionin e ultë të rrjetit të shpërndarjes (0.4kV), që janë konsumator familjar kanë të drejt të vendosin kapacitete gjeneruese për vetkonsum me një fuqi të instaluar të njësisë së prodhimit në **bazë të energjisë së konsumuar** dhe në bazë të Pëlqimit Elektroenergjetik që nuk kalon 7 kW.”

Komenti 2. Të përfshihen konsumatorët e energjisë elektrike të kyçur në tensionin e mesëm të rrjetit të shpërndarjes (10kV dhe 35kV) në skemën mbështetëse me Neto Faturim

Neni 5 - Kriteret për përfshirjen në Skemat Mbështetëse, paragrafi 7 thotë kështu:

“Skema mbështetëse për konsumatorët energjisë elektrike të nivelit të ultë dhe të mesëm të rrjetit të shpërndarjes dhe transmetimit sipas par. 2, 3 dhe 4 të këtij Neni do të jetë me Neto Faturim.”

Ndërsa paragrafi 5 i këtij neni citon si në vijim:

“Konsumatorët e energjisë elektrike të kyçur në tensionin e mesëm të rrjetit të shpërndarjes (10kV dhe 35kV) dhe në rrjetin e transmetimit, që janë konsumator jo-shtëpiak kanë të drejt të vendosin kapacitete gjeneruese për vet-konsum me një fuqi të instaluar të njësisë së prodhimit në bazë të fuqisë mesatare të angazhuar gjatë periudhës 12 mujore dhe në bazë të Pëlqimit Elektroenergjetik që nuk kalon pragun prej 200 kW.”

Në bazë të paragrafit 7 të këtij neni, nënkuptohet që konsumatorët e energjisë elektrike të kyçur në tensionin e mesëm të rrjetit të shpërndarjes (10kV dhe 35kV) dhe në rrjetin e transmetimit, që janë konsumator jo-shtëpiak nuk do të jenë pjesë e skemës mbështetëse me Neto Faturim. INDEP rekomandon që kjo kategori e konsumatorëve duhet të jetë gjithashtu e përfshirë në skemën mbështetëse me Neto Faturim.

Komenti 3. Të bëhen analiza dhe konsultime shtesë, në mënyrë që të rritet niveli nga 10% në 15-20% për prosumatorët të cilët gjatë vitit kalenderik prodhojnë më tepër sesa konsumojnë

Neni 5 – Kriteret për përfshirjen në Skemat Mbështetëse, paragrafi 8 citon kështu:

“Prosumatorët të cilat gjatë vitit kalenderik prodhojnë më tepër se 10% sesa konsumojmë, do ta humb Statusin e Prosumatorit në momentin e vërtetimit të tij nga ana e operatorit të shpërndarjes apo të transmetimit në varësisht prej nivelit të kyçjes.”

Analizat e bazës së energjisë së konsumuar, niveli i konsumatorit dhe teknologjia e vendosur janë disa nga pikat të cilat analizohen para përfitimit të statusit të Prosumerit. Andaj niveli i tejkalimit të energjisë së prodhuar krahas konsumit të energjisë elektrike mund të përafrohet paraprakisht. Në raste të veçanta ku konsumatori prodhon më shumë sesa që konsumon, duhet të mirren parasysh shumë parametra, si stina e vitit, koha dhe dita. Andaj është e paarsyeshme që Prosumatori të humb statusin e tij, në rast që prodhon më tepër se 10% të konsumit. Për këtë arsye dhe për faktin e lehtësimit të kushteve për Prosumatorët besojmë që niveli duhet të jetë në 15-20%, e më pastaj të shqyrtohet humbja e statusit.

Komenti 4. Procedura për hyrjen në Skemën Mbështetëse të Faturimit Neto e konsumatorëve të energjisë elektrike që tashmë kanë instaluar objekte vetë-gjeneruese të mos fillojë nga pika fillestare

Tek Neni 7 – Skema mbështetëse e faturimit neto, paragrafi 4, rekomandojmë që të rishqyrtohet dhe të ndryshohet procedura e përcaktuar. Paragrafi 4 i këtij neni thotë:

“Konsumatorët e energjisë elektrike që tashmë kanë instaluar objekte vetë-gjeneruese, por dëshirojnë të hyjnë në Skemën Mbështetëse e Faturimit Neto sipas kësaj Rregulle, duhet të aplikojnë për Autorizim për ndërtim, në përputhje me kërkesat e Rregullës së Procedurës së për Autorizimit për e Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese. Pas përfundimit pozitiv të procesit të Autorizimit, këta konsumatorë të energjisë elektrike marrin ose jo statusin e Prosumatorit në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulle.”

Konsumatorët që tashmë kanë të instaluar panele solare dhe gjenerojnë energji elektrike nuk duhet që të aplikojnë për Autorizim për ndërtim, e të ballafaqohen me procedura të tjera në mënyrë që të jenë pjesë e skemës mbështetëse me faturim neto. Për konsumatorët aktual e të cilët gjenerojnë energji elektrike nga teknologjia e BRE-ve dhe për konsumatorët që synojnë të bëhen Prosumator, duhet të ketë vetëm lehtësime të procedurave e jo shtim të tyre.

Komenti 5. Të definohen kufijtë e lejuar të ndikimit negativ në rrjet dhe e drejta e plotë e operatorit të rrjetit për ndaljen e menjëhershme të objektit vetë-gjenerues të prosumatorit

Paragrafi 6 i Nenit 12 – Kërkesat teknike minimale për Prosumatorët i jep të drejtë operatorit të rrjetit që të kërkojë ndaljen e menjëhershme të objektit vet-gjeneruese. Ky paragraf thotë:

“Nëse ndikimi negativ në rrjet është mbi kufijtë e lejuar, operatori i rrjetit ka të drejtë të plotë të kërkojë ndaljen e menjëhershme të objektit Vetë-gjenerues të Prosumatorit. Në rast se ndikimi negativ vazhdon të mbizotërojë, operatori i rrjetit do të ndërpres dhe çaktivizojë operimin e mëtejshëm paralel të objektit Vetë-gjenerues të Prosumatorit me rrjet derisa arsyet për shkyçje të eliminohen në përputhje me përkufizimet përkatëse të dhëna në kodin përkatës të rrjetit. Vendimi për një shkyçje të tillë duhet të arsyetohet me arsyetim teknik dhe t'i dorëzohet me shkrim Prosumatorit nga operatori i rrjetit menjëherë.”

INDEP kërkon që të definohen saktë kufijtë e lejuar të ndikimit negativ në rrjet nga ana e Prosumatorit, në mënyrë që konsumatorëpt vetë-gjenerues të kenë sigurinë se do të operojnë pa ndërprerje të pajustificuara dhe të kenë parashikueshmërinë minimale të nevojshme para investimeve të tyre. Krahas sigurisë për konsumatorët, e drejta e operatorit të rrjetit për ndërprerje të tillë duhet të jetë e bazuar në argumente të fuqishme dhe të arsyeshme krahas ndikimit në rrjet.

Komenti 6. Prosumatorët të kenë të drejtën e ankesës në momentin e ndaljes së objektit vetë-gjenerues

Nenit 12 - Kërkesat teknike minimale për Prosumatorët duhet të i shtohet edhe një paragraf ku i ofrohet e drejta konsumatorëve që të bëjnë ankesë nëse ndodh ndalja e objektit vetë-gjenerues nga ana e operatorit të rrjetit. E drejta e ankesës, pa marrë parasysh aspektet teknike duhet të i ofrohet të gjithë konsumatorëve. Andaj, një paragraf i tillë është i domosdoshëm që të shtohet.

Përfundime

Draft rregulla për vet-konsumatorët me burime të ripërtëritshme është rregullore e duhur dhe dokumenti i cili do të kontribuon në shtimin e gjenerimit të energjisë së decentralizuar dhe të pastër. Strukturimi është i qartë dhe gjithëpërfshirës. Andaj shpresojmë që kjo rregull do t'i paraprijë shtimit të gjenerimit nga ana e konsumatorëve të energjisë elektrike.

INDEP ka analizuar këtë rregullore dhe ka komente të cilat do të kontribuonin në përmirësimin e mëtejshëm të këtij dokumenti dhe të efektit që ky dokument ofron. Ani pse dokumenti është në të mirë të sektorit elektroenergjetik e sidomos sektorit të BRE-ve, dokumenti miratohet në një kohë kur grupi punues brenda Ministrisë së Ekonomisë është duke përgatitur Ligjin për Burime të Ripërtëritshme. Ky Ligj, bazuar në Koncept Dokumentin e miratuar më parë, do të rregulloj edhe fushën e konsumatorëve me vet-gjenerim (Prosumers). Fusha e konsumatorëve vet-prodhues do të jetë subjekt i debatit të gjerë shoqëror kur të miratohet Ligji dhe edhe pse ZRRE nuk ka pritur miratimin e Ligjit të ri, konsiderojmë që kjo Rregullore duhet të jetë patjetër në përputhje me Ligjin e ri, kurdo që ai miratohet.

Dokumenti ka edhe disa të meta, të cilat mund të përmirësohen e të japin efekt edhe më të madh. Duke filluar nga barra e shtuar në disa procedura që i është ngarkuar prosumatorit, kufijtë teknik dhe anashkalime të disa konsumatorëve. Të gjitha këto do të mund të mbuloheshin e të lehtësoheshin, e në të ardhmen do të ofronin numër të shtuar të Prosumatorëve.